**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE**

| Nr. Rendor [1] | Data e kërkesës[2] | Objekti i kërkesës[3] | Data e përgjigjes[4] | Përgjigje[5] | Mënyra e përfundimit të kërkesës[6] | Tarifa[7] |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 24.10.2022 | Kërkesë për informacion: 1. Vënie në dispozicion një kopje e kontratës së bashkëpunimit mes Ministrisë së Kulturës dhe Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim AADF, për krijimin e:<br><br>- TID Tirana<br><br>- TID Vlora<br><br>- TID Korça<br><br>BID Korça | 15.11.2022 | Kërkuesit i është vendosur në dispozicion informacioni i kërkuar. | Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail | Nuk ka |

---

[1] Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve
[2] Data e regjistrimit të kërkesës
[3] Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
[4] Data e kthimit të përgjigjes
[5] Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
[6] Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar
[7] Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | - TID Kruja<br><br>- BID Shkodër<br><br>- BID Berat<br><br>2. Cili është roli I Ministrisë së Kulturës në lidhje me krijimin dhe menaxhimin e këtyre entiteteve?<br><br>3. A ka fuqi vendimmarëse Ministria e Kulturës për sa i përket zhvillimeve në këto entitete?<br><br>4. Cili kuadër ligjor është përdorur për krijimin e këtyre entiteteve dhe vënien në dispoziciont të<br><br>pronës publike për zhvillim?<br><br>5. Vënie në dispozicion një kopje e statutit të:<br><br>- TID Tirana<br><br>- TID Vlora | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | - TID Korça<br>-BID Korça<br>- TID Kruja<br>- BID Shkodër<br>- BID Berat | | | | |
| 2. | 28.10.2022 | Kërkesë për informacion rreth Mozaikut te Tiranes<br>1. Si ishte dhe si eshte ky objekt? (Apo si parashikohet te jete)<br>2. Pse pikerisht keto ndryshime? Cilat ishin pikat ku u has nje nevoje nderhyrjeje?<br>3. Ku eshte bazuar informacioni mbi nderhyrjen?<br>4. Foto lidhur me kete ceshtje. | 7.11.2022 | Kërkesa është orientuar drejt intitucionit përkatës që ka në administrim objektin. | Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail | Nuk ka |
| 3. | 28.10.2022 | Kërkesë që disa xhirime të promos televizive dhe disa dokumentarëve të bëhen brenda territorit të | 7.11.2022 | Subjekti te percjelle kerkesen e plote lidhur me destiancionet qe do te realizoje filmimet dhe fotografimet dhe perdorimi i tyre ne | Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Shqipërisë, më saktësisht në disa qendra kulturore. Andaj, nëse mundeni që gjatë ditës së sotme ju që të na e përgatisni një dokument, i cili na lejon të bëjmë xhirimet. | | kuader te cilit emision apo reportazh. Kerkesa duhet te shoqerohet me nje shkrese zyrtare te firmosur nga titullari i saj si nje komunikim zyrtar per te vijuar me pas me trajtimin e kesaj praktike. | | |
| 4. | 4.11.2022 | Informacion dhe dokumentacion se si mund të veprohet për investimin e vendosjes së një Treni për turistët në Syrin e Kaltër | 7.11.2022 | Kërkesa është orientuar drejt intitucionit përkatës sipas fushës së përgjegjësisë. | Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail | Nuk ka |
| 5. | 22.10.2022 | 1. Cilat janë institucionet tuaja të varësisë të cilat paguajnë godina me qera?<br><br>2. Sa është hapësira e këtyre godinave?<br><br>3. Sa godina të tilla ka secili prej institucioneve?<br><br>4. Cila është shuma totale e qerasë së këtyre godinave me dhe pa TVSH? | 4.11.2022 | Kërkuesit I është vendosur në dispozicion informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar. | Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 5. Kur ka nisur kontrata e qerasë? | | | | |
| 6. | 15.11.2022 | Informacion lidhur rikonstruksion e fshatit Tragjas nga projekti 100 Fshatra.<br><br>1)A janë në dijeni Ministria e Kulturës apo edhe instancat e tjera lidhur me gjendjen e rrugës?<br><br>2)Nëse po, cila është arsyeja që edhe paskëtij projekti, punimet e të cilit kanë përfunduar në vitin 2020 nuk ka pasur ndërhyrje për të rregulluar apo qoftë edhe për të përmirësuar gjendjen e rrugës?<br><br>2)Kur pritet që të ketë mbështetje për infrastrukturën rrugore në fshatin Tragjas? | 18.11.2022 | Kërkesa është orientuar drejt intitucioneve përkatës sipas fushës së përgjegjësisë. | Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail | Nuk ka |
| 7. | 24.11.2022 | 1. Masat ligjore që duhet të ndërmmarrë shteti shqiptar, për | 05.12.2022 | Për ndryshimin e emrave të vendodhjeve në aplikacionin Google | Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ndryshimin e emërtimeve në google maps nga greqisht në shqip?<br><br>2. A keni akses që të dhëna të tilla të jenë të pandryshueshme nga persona të tjerë?<br><br>3.A keni komunikuar me autoritetet përkatëse për korigjimet e emërtimeve të sipërpërmendura? | | Maps kanë akses dhe mund të kryhet nga cdo individ nëpërmjet aplikacionit pa pasur nevojë për ndërhyrjen e institucioneve shtetërore. | | |
| 8. | 08.11.2022 | 1. Informacion në lidhje me rimbursimin e TVSH-së në rast të lidhjes së kontratës në kuadër të projektit EU4Culture.<br><br>2.Informacion në lidhje me procedurën e aplikimit për rimbursim në rastin e lidhjes së kontratës. | 14.12.2022 | Kërkesa është orientuar drejt intitucionit përkatës sipas fushës së përgjegjësisë. | Përfunduar. Kthim përgjigje me shkresë | Nuk ka |
| 9. | 22.11.2022 | Informacion në lidhje me procedurën e dhurimit të librave fond aneks i Bibliotekes se Vjeter. | 15.12.2022 | Në kuadër të organizimit të veprimtarive të Tetorit të Librit, me moton “Libri ofron botën”, Ministria e | Përfunduar. Kthim përgjigje me email. | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Kulturës, në bashkëpunim me Bibliotekën Kombëtare, me qëllim pasurimin e disa prej bibliotekave publike të qyteteve kryesore të vendit, ka ndërmarrë nismën të dhurojnë një sasi materialesh bibliotekare (libra), nga fondet e Bibliotekës Kombëtare, të cilat janë mbi 5 (pesë) kopje për çdo botim.<br>5 (pesë) kopje të çdo botimi që gjënden në institucion do të qëndrojnë në institucion, kopje të cilat duhet të jenë të rregullta, të plota (të pa dëmtuara). | | |
| 10. | 25.11.2022 | 1.A ka monumente kulture që u përmbytën nga vërshimi i lumenjve? Nëse po, ju lutem na e bëni me dije se cilat janë konkretisht.<br>2.A ka monumente | 14.12.2022 | Deri më sot, referuar inspektimeve nga Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (DRTK), kemi dy monumente të cilat kanë pasur dëmtime | Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kulture që janë dëmtuar nga rënia e shirave me intensitet të lartë për disaditë?<br>3.Nëse po, ju lutem na e bëni me dije se cilat janë konkretisht.<br>4.Nëse ka Monumente Kulture të dëmtuara, çfarë masash do të merren për rikthimin e tyre në normalitet?<br>5.A ka një përllogaritje të dëmeve të shkaktuara në vlera financiare?<br>6.A ka një përllogaritje të ndërhyrjeve për restaurimin e tyre, në vlera financiare? | | nga përmbytjet dhe vërshimi i lumenjve.<br><br>1. Xhamia e Plumbit, Shkodër;<br>2. Ura e Baçallëkut, Shkodër;<br>3. Kisha e Shirqit, Shkodër.<br><br>Në lidhje me Xhaminë e Plumbit, Ura e Bahçallekut mbi Drin, Kisha e Shirqit, kemi të bëjmë me përmbytje, prezencë të ujit,për shkak të vërshimit të lumejve të cilët në periudha me reshje të shumëta, mbartin dhe sasinë e ujit nga shkarkimet herë pas here të detyrueshme të kaskadës së Drinit. Për sa më sipër dhe për vetë specifikën e periudhës së reshjeve vjeshtë-dimër është e pamundur ndërhyrja e çfarëdo niveli dhe me cfarëdo lloj kapaciteti, pa u ulur niveli i lumenjve Drin dhe | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Buna.<br>Mbrojtja e këtyre pasurive kulturore arrihet vetëm me ndërtimin e sistemeve mbrojtëse(dige) siç dhe parashikohet të ndërtohet përreth Xhamisë së Plumbit, apo argjinaturave përgjatë lumenjve rasti i Kishës së Shirqit, për parandalimin e rrjedhës dhe vërshimit të ujrave pranë këtyre pasurive.<br>Gjithashtu, sjellim në vëmendje se ndërhyrje të tilla si diga, ura etj, nga pikëpamja logjistike kërkojnë bashkëpunim me institucionet e specializuara për hartimin e veprave të tilla publike. | | |
| 11. | 21.11.2022 | Perse nuk ka nisur projekti per restaurimin dhe sistemimin nga furia e ujrave ne Xhamine e Plumbit ne Shkoder? Cfare ka ndodhur nderkohe? | 6.12.2022 | Kërkuesit i është vendosur në dispozicion informacioni i kërkuar. | Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Ju lutem te na vini ne dispozicion projektin e investimit ne Xhamine e Plumbit ne Shkoder. | | | | |
| 12. | 6.12.2022 | Duam te bejme aplikim per te drejten e autorit per nje liber qe eshte cikel leksionesh nga nje Institucion shkollor, pra nuk ka emer idividi qe ka bere librin, eshte cikel leksionesh ne baze te shume viteve mesimdhenie .<br>Kur eshte rasti i tille si te aplikojme per te mare te drejten e autorit ,te bejme aplikimet e nevojshme qe te dale ne emer te Institucionit shkollor . | 15.12.2022 | Në kuptim të ligjit nr. 35/2016 *"Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to",* i ndryshuar, autor është çdo person fizik ose një grup personash fizikë, që krijon vepër letrare, artistike, shkencore, produkt intelektual origjinal, i materializuar, pavarësisht nga forma dhe mënyra e të shprehurit.<br>Të drejtat e autorit i përkasin, nga natyra, personit fizik, i cili ka krijuar veprën. | Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail | Nuk ka |
| 13. | 09.12.2022 | Si menaxhohet Kalaja e Rodinit, në Qarkun e Durrësit?<br>Rendisni ndërhyrjet restauruese që janë bërë në këtë monument në pesë vitet e fundit?<br>Na vini në dispozicion një kopjo të kartelës së | 19.12.2022 | Kërkuesit I është vendosur në dispozicion informacioni i kërkuar. | Përfunduar. Kthim përgjigje me e-mail | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | këtij monumenti.<br>A ka realizuar institucioni studim mjedisor për këtë monument?<br>Si realizohet mirmbajtja e këtij monumenti?<br>A ka pasur dëmtime monumenti si pasojë e tërmetit të 26 nëntorit 2019? Nëse po rendisni konstatimet.<br>A keni konstatuar prani të ndotjes mjedisore, si pasojë e ndotjes urbane në monument?<br>A ka infrastruktrë për mbledhjen e mbetjeve, që lihen nga turistët në zonë? | | | | |
| 14. | 04.10.2022 | Kërkesë për vënie në dispozicion të kopjeve të relacioneve të Vendimeve të Këshillit të Ministrave, të miratuara gjatë 4 mujorit të parë të vitit 2022 të propozuara nga Ministri i Kulturës. | 05.01.2023 | Kërkuesit i është vendosur në dispozicion dokumentacioni i kërkuar pas vendimit nr. 65, datë 23.12.2022 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit. | Përfunduar. Kthim përgjigje me shkresë. | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 15. | 10.10.2022 | Kërkesë për vënie në dispozicion të kopjeve të relacioneve të Vendimeve të Këshillit të Ministrave, të miratuara gjatë periudhës maj-shtator 2022 të propozuara nga Ministri i Kulturës. | 05.01.2023 | Kërkuesit i është vendosur në dispozicion dokumentacioni i kërkuar pas vendimit nr. 65, datë 23.12.2022 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit. | Përfunduar. Kthim përgjigje me email. | Nuk ka |
| 16. | 27.12.2022 | A janë bërë vitet e fundit ispektime në objektin Ura e Zogut, në shtratin e lumit Mat? Nëse po na vini në dispozicion një kopjo të raportit.<br><br>Na vendosni në dispozicion kartelën e monumentit<br><br>A janë ndërmarë gjatë viteve të fundit ndëhyrje në këtë objekt? Nëse po, çfarë? Nëse jo a parashikohet që të ndërmeren?<br><br>A janë konstatuar cilët janë shkakëtarët e | 11.1.2023 | 1. Inspektimi i fundit i kryer në objektin pasuri kulturore “Ura e Matit” është kryer nga Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Shkodër në muajin Dhjetor 2022, në kuadër të inspektimeve të kryera si rrjedhojë e problematikave të shkaktuara nga reshjet.<br>2. Për sa I përket ndërhyrjeve në vitet e fundit, lidhur me problematikën që paraqet dhe që është konstatuar në këtë strukturë nga institucione të | Përfunduar. Kthim përgjigje me email. | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dëmtimit ndër vite të këtij monumenti? | | ndryshme si Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore është ndërmarrë nisma për ngritjen e një grupi ndërinstitucional me qëllimin për bashkëpunimin për përcaktimin e ndërhyrjeve të nevojshme në këtë strukturë.<br>3.Sqarojmë se nyja e nxjerrjes së zhavorrit, inerteve është në një gjatësi prej 1 km nga objekti pasuri kulturore, praktikisht jashtë "zonës së mbrojtur" të objektit, por nxjerrja e këtyre inerteve ka bërë që rrjedha e lumit të meandrojë drejt pikës më të dobët të urës, ku këmbët janë me struktura prej hekuri. Institucionet e varësisë së Ministrisë së Kulturës nuk kanë kompetencë të ndërhyjnë në një territor jashtë | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | monumentit dhe zonës së mbrojtur të tij por e ka ngritur si çështje në komunikimet zyrtare me institucione të tjera kompetente.<br>4. Aktualisht në objekt është e pamundur ndërhyrja për shkak të nivelit të lartë të ujrave. Theksojmë se gjatë stinës së dimrit, lumi Mat, mbart edhe shkarkimet nga kaskada e Shkopetit prandaj ndërhyrje të tilla inxhinierike duhet të kryhen në periudha gjatë vitit kur ka thatesirë.<br>5. Nga ekspertizat e kryera nga ekspertë të fushave përkatëse, arsyet e dëmtimeve në strukturë lidhen me erozionin (kushte gjeomorfologjike dhe gjeologjike), shfrytëzimi i shtratit të lumit për nxjerrjen e inerteve, ndryshimi i regjimit të rrjedhave lumore që furnizojnë | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | me inerte lumin Mat duke sjellë sasi depozitimesh aluviale të ulët, etj. | | |
| 17. | 27.12.2022 | Çfarë dëmesh kanë shkaktuar kompanitë që kanë pasur akses në (mbledhjen e inerteve, zhavorr, rërë, gurë) etj në lumin Mat, konkretisht në urën e Mbretit Zog?<br><br>2. Cila ka qenë periudha kur këto kompani kanë pasur akses(përcaktoni kohën)?<br><br>3. Çfarë masash keni marrë ju si institucion(përcaktojni) kundrejt kompanive si dhe kundrejt këtij fenomeni?<br><br>4. A janë vendosur kompanive përkatëse gjoba si dhe shuma e tyre? | 11.1.2023 | Nyja e nxjerrjes së zhavorrit, inerteve është në një gjatësi prej 1 km nga objekti pasuri kulturore, praktikisht jashtë "zonës së mbrojtur" të objektit, por nxjerrja e këtyre inerteve ka bërë që rrjedha e lumit të meandrojë drejt pikës më të dobët të urës, ku këmbët janë me struktura prej hekuri.<br><br>Institucionet e varësisë së Ministrisë së Kulturës nuk kanë kompetencë të ndërhyjnë në një territor jashtë monumentit dhe zonës së mbrojtur të tij por e ka ngritur si çështje në komunikimet zyrtare me institucione të tjera kompetente. | Përfunduar. Kthim përgjigje me email. | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 5. Në çfarë periudhe janë vendosur gjobat?<br><br>6. Çfarë masash keni marrë për rikuperimin e dëmit urën e Mbretit Zog? | | Lidhur me problematikën që paraqet dhe që është konstatuar në këtë strukturë nga institucione të ndryshme si Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore është ndërmarrë nisma për ngritjen e një grupi ndërinstitucional me qëllimin për bashkëpunimin për përcaktimin e ndërhyrjeve të nevojshme në këtë strukturë<br>Aktualisht në objekt është e pamundur ndërhyrja për shkak të nivelit të lartë të ujrave, pasi theksojmë se gjatë stinës së dimrit, lumi Mat, mbart edhe shkarkimet nga kaskada e Shkopetit. Ndërhyrje të tilla inxhinierike duhet të kryhen në periudha gjatë vitit kur ka thatësirë. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 18. | 16.11.2022 | 1. Cilat jane vlerat konkrete financiare qe ka perfituar secili subjekt (ojf dhe individe) nga perdorimi i fondit publik per projektet kulturore 2022. Na dergoni vleren per secilin.<br>2. Per fituesit e Thirrjes (ojf ose individe) na jepni informacion mbi bashkine ku jane regjistruar per aktivitetin (per ojf-te), apo ku banojne (per individet).<br>3.kemi konstatuar se Ministria e Kultures ka publikuar ne faqen zyrtare nje njoftim, mbi Thirrjen e projekteve kulturore 2022, me date te fallsifikuar. Publikimi eshte bere faktikisht me date 04.02.2022 kurse ju e keni pasqyruar ne faqe sikur eshte bere me date 31.01.2022. A ka mase displinore ndaj ketij fallsifikimi? Nese | 12.1.2022 | Kërkuesit i është vendosur në dispozicion informacioni i kërkuar. | Përfunduar. Kthim përgjigje me email. | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ka masa te marra nga institucioni, na paraqisni dokumente mbi shqyrtimin apo te vendimarrjes per shkatarin (shkaktaret).<br>4. Cilet ishin anetaret e komisionit vleresues te Thirrjes per projekte 2022? Na dergoni dokumentin e vendimarrjes per ngritjen e komisionit. | | | | |